
PEDAGOGICAL METHODS IN PIANO TECHNICAL DEVELOPMENT

Alba Muqolli-Dehiri

Kosovo, Haxhi Zeka University, Kosovo, alba.muqolli@unhz.eu

Mimoza Pajaziti-Drançolli

Kosovo, Haxhi Zeka University, Kosovo, mimoza.pajaziti@unhz.eu

Abstract: Music education has a great influence on the psycho-social and intellectual development of children. This process involves a number of tasks that need to be addressed and applied from early childhood, from 7 years of age respectively (based on the school system applied in our country).

An instrumentalist has to pass through a long way to his final formation as a musician. It is a long educational process with challenges and disciplines, without which it is not possible to create an instrumentalist. During the musical education, the student passes on different challenges such as: examination at the end of the year, auditions for concerts but the main challenge remains to be presentation in front of the public or concerto, where this process is identified with the increased sense of responsibility for the correct realization of the musical work by the interpreter. Such a process is not easy to interpret.

In this journey, the pedagogue plays a very important role. The pedagogical methods he uses to achieve the desired goals are key parameters in the formation of the instrumentalist, the new pianist. During music education, piano pedagogues use different techniques of piano lesson, depending on the psycho-physical capacity of the child. Piano techniques have a basic role in the study of a piano work where the realization of this work segment comes to the full interpretation of that work.

This work would be in itself the elaboration of certain tasks in the achievement of piano technique, as one of the most important segments of pianistic interpretation. Methods of the technical processing of the various problems we face in the piano works will be introduced, respectively the importance of the pedagogue in the creation of the expression of the technical processing by the pupils will be elaborated.

During the pedagogical work and when dealing with the work on piano technique, the pedagogue must be able to detect any technical deficiencies in the pupil. Regarding this work, the most common defects we encounter in the pupils during pianistic education will be described and instructions will be given on how to overcome, respectively how to reach the right musical targets.

The technical pianistic advancement is closely related to the sound score we gain in the pianistic interpretation. Therefore, the segment of the pianist technique in music is valued and ranked as one of the key segments of interpretation, so this work will be more than necessary for new pedagogues so that they can access the theoretical literature on their ways of working with pupils in the problem of piano technique.

The paper will consist of: introduction, objectives, discussion, conclusion.

Keywords: methods, pedagogue, technique.

METODAT PEDAGOGJIKE NË ZHVILLIMIN TEKNIK PIANISTIK

Alba Muqolli-Dehiri

Kosova, Universiteti Haxhi Zeka, email: alba.muqolli@unhz.eu

Mimoza Pajaziti-Drançolli

Kosova, Universiteti Haxhi Zeka, email: mimoza.pajaziti@unhz.eu

Abstrakti: Edukimi muzikor ka ndikim të madh në zhvillimin psiko-social e intelektual tek fëmijet. Ky proces përfshin një sërë detyrash të cilat duhet të trajtohen e aplikohen që nga fëmijëria e hershme përkatsisht nga moshë

7-vjeçare (duke u bazuar në sistemin shkollor që aplikohet në vendin tonë).

Një instrumentist e pret rrugë e gjatë deri te formimi i tij final si muzikëtar. Është një rrugë e gjatë shkollimi përplot sfida dhe discipline, pa të cilat nuk është e mundur formimi i një instrumentisti. Gjatë shkollimit muzikor, nxënësi kalon në sfida të ndryshme siç janë; provimet për notim në fund të vitit, audicionet për koncerte por sfida kryesore mbetet të jetë paraqitja para publikut apo koncertimi, me ç'rast ky proces identifikohet me ndjenjen e shtuar të përgjegjësisë mbi realizimin e vepres muzikore në mënyrë korrekte nga ana e interpretit. Nje proces i tillë del të jetë jo i lehtë për interpretet.

Në këtë rrugëtim, rol shumë të rëndësishëm luan pedagogu. Metodot pedagogjike që ai përdor për të arritur deri te caqet e dëshiruara, janë parametra kyçe në formimin e instrumentistit gjegjësisht pianistit të ri. Gjatë

shkollimit muzikor ,pedagogët e pianos përdorin teknika të ndryshme të mësimi pianistik mvarësisht nga kapaciteti psiko-fizik i fëmiut.Teknikat pianistike kanë rol bazë në studimin e një veprë pianistike ku me realizimin e këtij segmenti te punes vjen në shprehje realizimi i plotë - interpretimi i asaj veprë.

Ky punim do të ngërthej në vehte pikërisht elaborimin e detyrave të caktuara në arrijten e teknikes pianistike, si një nga segmentet shumë të rëndësishëm të interpretimit pianistik. Do te jenë të parashtruara mënyrat e përpunimit teknik të problematikave të ndryshme që hasim në veprat pianistike respektivisht do të elaborohet rëndësia e pedagogut në krijimin e shprehisë së përpunimit teknik nga ana e nxënësve.

Gjatë punes pedagogjike dhe kur kemi të bëjmë me punen në tekniken pianistike, pedagogu duhet të jetë i aftë që të detektojë mangësit eventuale teknike tek nxënësi. Lidhur me këtë në punim do te jenë të përshkruara defektet me të shpeshta që i hasim tek nxënësit në shkollimin pianistik dhe do të jipen udhëzime se si të tejkalohen respektivisht si të arrijmë tek caqet e duhura muzikore.

Avancimi teknik pianistik është i lidhur ngushtë me rezultatin tingullor që e fitojmë në interpretimin pianistik. Prandaj, segmenti i teknikes pianistike në muzikim, vlerësohet dhe rangohet si një nga segmentet kyqe të interpretimit, prandaj ky punim do të jetë më se i nevojshëm për pedagogët e rinj në mënyrë që të kenë qasje në literuren teorike mbi mënyrat e punës së tyre me nxënësit në problematiken e teknikes pianistike.

Punimi do te përmbajë;hyrjen, objektivat, diskutimin, konkluzionin.

Fjalët kyqe:metoda,pedagogu,teknika.

1.HYRJE

Edukimi muzikor është plotësim i intelektit njerëzor i cili filllet e tij i ka qysh në fëmijëri. Metodot pedagogjike kushtëzohen kryesisht nga pregaditja psiko- fizike e fëmiut që do të thot se një metodë nuk është gjithmonë e suksesëshme për të gjithë nxënësit andaj nga pedagogu kërkohet të praktikoj metoda të përshtatshme për çdo nxënësi në veqanti. Dëshira për muzikën dhe interpretimin është mjeti më i fort që një fëmijë duhet ta ketë me qëllim që të zhvilloj aftësit për interpretimin në instrument. Në këtë punim do të trajtohen metodot pedagogjike, mënyrat se si duhet pedagogu t'i qaset fëmiut për të arritur një interpretim sa më të bukur të një ideje muzikore e deri te realizimi i plotë i vepres muzikore me kërkesat dhe problemet që i ka përmbrnda.

Do të trajtohen format se si pedagogu duhet të qaset metodave pedagogjike për formimin dhe zhvillimin e një pianisti qysh në moshën fëmijërore.Theks te veqantë do te ketë trajtimi i problematikave teknike, si një nga elementet kyqe të realizimit final të veprave muzikore pianistike.

2.QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i punimit është të evidentohen problemet që zakonisht paraqiten tek nxënësit në fillimet e mësimi të instrumentit të pianos, njëkohësisht të vështrohet dhe analizohet roli i pedagogut në përmirësimin e shprehive që janë në ndërtim tek nxënësit fillestar dhe metodot pedagogjike të përdorura për arrijten e drejtë të teknikes pianistike.Ky punim ka për synim që t'ju ndihmoj pedagogeve të rinj që të kenë një informatë direkte rreth përpunimit teknik të elementeve të ndryshme muzikore në punën e tyre pedagogjike me nxënësit fillestar në instrumentin e pianos.

Si objektiva kryesore që do të trajtohen në punim janë:

1. Rëndësia e kohëzgjatjes së orës mësimore tek fillestarët.
2. Të shtjellohet roli i pedagogut dhe metodave pedagogjike të përdorura gjatë procesit mësimor.
- 3.Të evidentohen problematikat teknike që shfaqen tek nxënësit fillestar dhe mënyra se si te arrihet deri te interpretimi i suksesëshëm teknik.

2.1. Rëndësia e kohëzgjatjes së orës mësimore tek fillestarët.

“ Muzika është një labirint pa fillim dhe pa mbarim, plot me shtigje të reja për tu zbuluar, ku misteri mbetet i përjetshëm”

PIERRE BOULEZ

Me frazen e lartëcekur, e thënë nga dirigjenti, kompozitori i njohur botëror Pierre Boulez, nënkuptojmë rrugën e gjatë që e pret një instrumentist deri te formimi i tij final si muzikëtar. Është një rrugë e gjatë shkollimi përplot sfida dhe disiplinë, pa të cilat nuk është e mundur formimi i një instrumentisti.

Në këtë rrugëtim, rol shumë të rëndësishëm luan pedagogu. Metodot pedagogjike që ai përdor për të arritur deri te caqet e dëshiruara, janë parametra kyqe në formimin e instrumentistit gjegjësisht pianistit te ri.

Mësimi i instrumentit fillon tek fëmijet e moshës së re (6-8 vjeq). Duke pas parasysh që kemi të bëjmë me një moshë mjaft të re, ora mësimore preferohet fillimisht mos të jetë më e gjatë se 15 -20 minuta. Arsyeja kryesore për një kohëzgjatje të tillë vjen si rezultat i mbajtjes në nivel të koncentrimin të nxënësit në raport me informata që do të merë ai gjatë kësaj kohe. Meqë ora e instrumentit eshte orë individuale, informata që ai merrë mbrenda kësaj kohe nga pedagogu nuk janë te pakta për moshen.

2.2.Roli i pedagogut dhe metodave pedagogjike të përdorura gjatë procesit mësimor.

*“Pedagogu duhet ti ofroj nxënësit atë që quhet shkollë”***A. Goldenvajzer, E.M.Timakin, Beograd 1984**

Detyrë e pedagogut në orët e para të pianos është të flitet rreth qëndrimit në instrument. Qëndrimi i drejtë i trupit, pozicionimi i drejti i karriges së pianos, lëshimi i drejtë i aparatit pianistik që nga krahu e deri të majat e gishtërinjëve në tastaturë si dhe elasticiteti i kësaj pjese të trupit, janë informatat më të rëndësishme që pedagogu duhet ti përcjellë tek nxënësi.

Suksesi i arritjes së realizimit të elementeve të lartëcekura nuk mund të bëhet brenda orës apo muajit. Është një proces që zgjatë që nga ora e parë e deri të pjekuria e plotë e instrumentistit e kjo varet shumë nga aftësit psikofizike të secilit nxënës në veqanti. Pedagogu përmes insistimit të tij të vazhdueshëm, mbjell tek nxënësi kulturën e përdorimit të të gjitha pjesëve të trupit gjatë interpretimit të vepres muzikore, qoftë ajo edhe nje frazë e thjeshtë muzikore e luajtur me një dorë. Themi “gjithë pjesëve të trupit”, meqë i gjithë trupi është pjesëmarrës në interpretimin muzikor të vepres, mbështetemi në këmbë, aparati pianistik kryen punën e vet ndërsa trupi (pjesa e lartë) ndihmon në arritjen sidomos të dinamikave të larta muzikore të cilat mund të arrijne deri në fff (tri forte).

Në takimin e parë të nxënësit me tastaruren e pianos respektivisht me lojen e një fraze të shkurt muzikore të përbërë prej 4-5 tingujëve, zakonisht ndodh që vjen deri te shtangimi i aparatit pianistik. Përmes sqarimit të rëndësishë mbi lirinë e supeve, krahut, llëres dhe gishtërinjëve, pedagogu duhet të përcjellë tek nxënësi rëndësine e liritimit të aparatit pianistik. Gishtërinjet në formë të gjysëmharkut mbështeten në tastaturë duke hyrë deri në thellësi të tastit dhe njëkohësisht duhet të arrihet liria e plotë e pjesëve të larta të aparatit.

Në momentin që kemi bërë progres në këtë pikë, vazhdojmë me interpretimin e dy, tri e më shumë tingujëve gjithnjë duke mbajtur nën kontrollë lirinë e aparatit pianistik. Në këtë rast, krahu në mënyre konstante përcjell punën e gishtërinjëve deri sa ata luajnë njeri pas tjetrit duke ruajtur formen dhe thellësinë në të cilën duhet hyrë. Kjo është e lidhur ngusht me rezultatin tingullor që duhet fituar. Gjithë puna teknike që bëhet mbrenda vepres muzikore, bëhet në favor të rezultatit muzikor. Teknika pianistike është e lidhur ngushtë me tingullin muzikor. Pa zhvillim të duhur teknik, nuk mund të presim rezultat të mirë tingullor. Një interpret i cili nuk është zhvilluar në aspektin teknik të lojes pianistike, e ka të pamundur realizimin e ideve muzikore që synohen brenda vepres muzikore.

2.3. Problematikat teknike që shfaqen tek nxënësit fillestar dhe mënyra se si te arrihet deri te interpretimi i suksesëshëm teknik.

Në vazhden e problematikave teknike, do të përmendim disa prej elementeve teknike tek të cilat kërkohet një trajtim i veçantë dhe një mënyrë e caktuar e punës në ciklin fillestar të mësimin pianistik.

Një rëndësi të veçantë në avancimin teknik, luajnë shkallët muzikore. Është i njohur fillimi i orës së instrumentit me realizimin e shkalleve. Shkallët muzikore i mundësojnë pianistit të ri të fitojë shpejtesinë, saktësinë dhe njëtrajtshmërinë tingullore. Këto tri parametra të fituara me ushtrimin e shkallëve, i mundësojnë atij që çdo pasazh të paraqitur në veprat muzikore, ta përballojë më lehtë sesa në rastin e kundërt (nëse nuk ushtrohen shkallët). Pedagogu duhet të bëjë spjegimin teorik të ndërtimit të shkallëve, të qartësojë menyrat e lojes së tretëingjllimit dhe katërtëingjllimit, të jetë insisues në aplikaturen e saktë (renditjen e gishtërinjëve) dhe stabilitetin ritmik si dhe të kërkojë gradualitetin dinamik.

Interpretimi i akordeve të zbrërhyera apo arpegjove, paraqet një tjetër sfidë teknike para nxënësit. Sikurse te shkallët, edhe te arpegjot duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë nënvenies së gishtit të parë te dores. Meqë gishti i parë është gisht më i fuqishëm i dorës, gjithnjë ekziston ‘reziku’ që kur ky gisht luan, të krijoj theks të padëshiruar një rrjedhen tingullore te shkallës apo arpegjos. Pedagogu duhet të kërkojë nga nxënësi që të ketë kujdes në nënvenien e gishtit të parë respektivisht kur luan ky gisht, pesha e dores duhet të kontrollohet maksimalisht në mënyrë që të ketë rrjedhë graduale në harmoni me gishtat tjerë të dores.

Intervale muzikore (loja e njëkohshme e dy tingujve) paraqesin një punë në vehte në aspektin e avancimit teknik të interpretit. Sfidë të veçantë paraqet loja e intervalit të oktaves, i cili është një interval që kërkon hapje më të madhe të dores (largësi mes 8 tingujve). Vështërsi të theksuar këtu kanë pianistet me ndërtim më të vogël të dorës, meqë në të kundërtën kjo realizohet shumë më lehtë. Te pianistët me ndërtim të konsiderueshëm të dores, duhet pasur parasysh ruajtjen e elasticitetit të aparatit pianistik gjatë interpretimit të oktavave, të potencohet tingulli melodik dhe të ruhet gradualiteti dinamik. Ndërsa interpretimi i oktavave nga pianistet me ndërtim të vogël dore, duhet te pasur kujdes në elasticitetin e llëres dhe të bërrylit, meqë mund të vijë shume lehtë deri te kontraktimi i këtyre pjesëve të krahut.

Elemente të teknikes pianistike ka në numër të madh siç janë :trileret, glisandot, kërcimet, tremolot, akordet, artikulimi, legato, staccato, kërcimet e mëdha, goditja dhe marrja e tingullit. Të gjitha këto elemente, përgjate shkollimit muzikor mësohen me renditjen që janë parashtruar në planprogramet mësimore. Detyrë e pedagogut është që të përdore metodat pedagogjike të duhura në menyrë që të jetë sa me i qartë në kërkesat e tij ndaj nxënësit dhe te jetë këmbëngulës në punën sistematike të tij. Puna në avancimin

teknik të interpretit nuk është aspak e lehtë, kërkon një vullnet dhe ambicie të shtuar, kohe, disiplinë dhe angazhim shtesë nga interpreti i ri. Pa zhvillim teknik, nuk mund të arrijmë të realizojmë veprën në formën e saj muzikore dhe estetike. Një interpret që nuk është zhvilluar teknikut, nuk është i qartë muzikalisht, nuk mund të artikulojë tingujt muzikorë dhe mbetet i mangët në frazim. Prandaj, gjithnjë duhet pasur parasysh elasticitetin e aparatit pianistik, njëkohsisht zhvillimin e çdo pjese të tij në veçanti (supi, krahu, nënberryli, llëra dhe gishtërinjet) dhe bashkëpunimin e tyre në realizimin e drejtë të elementeve teknike muzikore.

3. DISKUTIM

Në këtë punim diskutohet dhe sqarohet kohëzgjatja e orës mësimore prej nxënësit fillestar. Kohëzgjatja e orës mësimore fillimisht duhet të jetë e shkurtër për shkak të koncentrimin të nxënësit ngase ora e pianos është orë individuale dhe pedagogu tërësisht i përkushtohet vetëm atij nxënësi. Si metodë fillestare pedagogjike është që pedagogu fillimisht të i shpjegoj nxënësit qëndrimin në instrument, lirim të krahut, lirim të dorës ngase me qëndrim të drejtë dhe aparaturë të liruar arrihet një prej rezultateve të kërkuara në realizimin e kërkesave pianistike në një vepër muzikore.

Një prej problematikave për interpretimin e veprave muzikore është teknika pianistike e cila mund të zhvillohet me ushtrime teknike të shkallëve me mënyra të ndryshme e cila ndikon shumë në lirim të aparatit pianistik dhe me lirim të gishtave dhe dorës vjen deri te realizimin i kërkesave dhe vështirësive teknike të veprave pianistike.

4. KONKLUZIONI

Ky punim i është kushtuar teknikes pianistike, meqë sa me të qarta janë detyrat muzikore aq më i lehtë dhe me i bukurë është interpretimi pianistik. Teknika pianistike ngërthen në vehte një sërë detyrash të cilat janë cekur më lartë, e të cilat duhet të parashtrihen çdo orë mësimore nga pedagogu dhe duhet të kryhen me përpikmëri nga ana e nxënësit. Në të kundërtën, nuk do të kemi rezultat pedagogjik të duhur respektivisht puna pedagogjike do të jetë e mangët dhe si rezultat do të kemi para vehtes një interpret jo të zhvilluar mirë, problematikat të cilat vështirë ose fare nuk mund të permirsohen në shkollimin e mëvonshëm. Të gjitha elementet e teknikes pianistike që janë cekur më lartë si dhe metodat pedagogjike që duhet përdorur për realizimin e drejtë të tyre, lehtësojnë punën e pedagogut të ri dhe i krijojnë qasje më të lehtë në informacionet teorike mbi evidentimin e problemeve fillestare që paraqiten te nxënësi në fillimet e tij të mësimin të instrumentit.

LITERATURA

- [1] Neuhaus, Heinrich, 2000 “O umjetnosti sviranja klavira”, Zagreb, Jaska Zlatar.
- [2] Krsic, Jela 1990. Nastavam klavira Beograd: Prosveta/ Promusica.
- [3] Timakin, Evgenij. 1984. Vaspitanje pianiste. Beograd: Udruzenje muzickih pedagoga.
- [4] Zlatar, Jaska. 1998. Uvod u klavirsko izvodjenje. Tirana: Albdesign.
- [5] <http://fundamentals of piano practice/>.